



Breaking News: Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, gjatë 24 orëve të fundit

⏏ ⏪ ⏩



LajmetOperacionet

23/04/2025

Tiranë – Finalizohet Operacioni I Koduar “Gracka”. Sekuestrohet 1 Pistoletë Me Municion

Tiranë/Operacione policore të njëpasnjëshme kundër armëmbajtjes pa leje.

Finalizohet operacioni “Gracka”. Sekuestrohet 1 pistoletë me municion.

U kap në flagrancë në zonën e Don Boskos, me armën e zjarrit që do ta shiste, vihet në pranga 23-vjeçari.

Si rezultat i kontrolleve të befasishme, të kryera në vijim të punës policore për garantimin e rendit dhe për goditjen e paligjshmërive, Seksioni i Hetimit të Trafiqueve të Paligjshme, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale, finalizoi operacionin “Gracka”.

Gjatë operacionit, u arrestua në flagrancë, në rrugën “Demir Progni”, shtetasi A. D., 23 vjeç, banues në Tiranë.

Nga kontrollet u konstatua se ky shtetas kishte me vete 1 armë zjarri pistoletë me municion luftarak, të cilën dyshohet se do ta shiste.

Vijojnë hetimet për të identifikuar dhe nxjerrë përpara përgjegjësisë penale, shtetas të tjerë që mund të jenë implikuar në këtë rast.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Shërbimet e Policisë ndihmojnë 3 turistë çekë që mbetën të bllokuar te shpella e Pëllumbasit

Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, gjatë 24 orëve të fundit ▶